

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: **MIN.E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILL. RURAL**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **203-24-1725-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Mbledhja e te dhënave statistikore – çmimeve (te tregut, fermës, inputeve dhe mekanizmit bujqësorë)**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	<b>GIS Data Project SH.P.K.</b>
NUI	<b>812075689</b>
Adresa	<b>Prishtinë</b>
Vendi	<b>Pristine</b>
Kodi postar	<b>10000</b>
Numri Telefonit	<b>Tomor Çela</b>
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	<b>Gis Data Project</b>
Adresa elektronike	<b>datagisproject@gmail.com</b>
Data e parashtrimit të ankesës	<b>03.05.2024</b>

*\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

#### 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

Emri i avokatit  
Adresa e plotë  
Numri i Telefonit  
Numri i faks-it  
Adresa elektronike

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

**Mbledhja e të dhënave statistikore – çmimeve (te tregut, fermës, inputeve dhe mekanizmit bujqësorë)**

**Ak ka shpallur procedurën e prokurimit me datë 01.03.2024**

**Afati i fundit për dorëzim: 26.03.2024 në ora 13:30:00**

**Procesverbali i Hapjes: 26.03.2024**

**Vendimi për dhënie të kontratës: 25.04.2024**

**Kërkesa për rishqyrtim nga OE, e vendosur në e-prokurimi: 30.04.2024**

**AK - Njoftim për kërkesën për rishqyrtim.pdf 30.04.2024 13:39**

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

Po ☐

Jo ☒

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

Po ☒

Jo ☐

### 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

*A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

Po ☒

Jo ☐

*Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë contestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.*

**Ne si OE kemi dorëzuar kërkesa për rishqyrtim duke e vendosur në e-prokurimi me datë 30.04.2024. Kërkesa është tek pjesa e e-prokurimit: Dokumente - Letër Standarde, e cila kërkesë ka qenë përparuar duke u bazuar në Formularin "F02**

**Formulari Standard per rishqyrtim te vendimit ne AK 30.04.2024\_F".**

**Në të njejtën datë (30.04.2024 ora 13:40) AK e ka derguar njoftimin për vendosjen e kërkesës për rishqyrtim ne forme elektronike ne plateformen e eprokurimit.**

**Me datën 01.05.2024 ne si OE kemi vendosur kërkesën e njejte tek menyja "Kërkesat për Rishqyrtim".**

**Me date 02.05.2024 AK ka publikuar vendimin per refuzim te kërkesës per rishqyrtim me arsyetimin si e jashtëafatshëm.**

**Arsyetim: AK me kete veprim ka shkelur në plotni Ligjin për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, NENI 108/A (Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve), paragrafi 3 (Kërkesa për shqyrtim duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj).**

**Nga kjo vertetohet se ne si OE kemi dorzuar me kohe - brenda afateve dhe mjeteve të lejuara me ligjin e lartëshenuar kërkesën për rishqyrtim (datë 30.04.2024), por AK qellimshëm ka manipuluar me procedurën, dhe duke anashkaluar procesin e rishqyrtimit ka vepruar njanshëm, dhe jashtë rregullave ka deklaruar mbetjen në fuqi të njoftimi të vendimit nga AK.**

## **7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

AK ka shkelur në plotni 1) Ligjin Nr. 04/L-042, PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092; **Neni 7** (Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi), **paragrafi 1 deri 6**. 2) Ligjin për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, **NENI 108/A** (Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve), **paragrafi 3**. B. Dosjen e Tenderit - Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT) Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, Kërkesa 1 dhe 2.

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

## **8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

AK ka shkelur në plotni 1) Ligjin Nr. 04/L-042, PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,

I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092; **Neni 7** (Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi), **paragrafi 1 deri 6. 2)** Ligjin për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, **NENI 108/A** (Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve), **paragrafi 3. B.** Dosjen e Tenderit - Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT) Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, Kërkesa 1 dhe 2.

**Sqarim:** Ne kemi ofruar dëshmi të mjaftueshme lidhur me referencat e natyrës së shërbimeve, si dhe qarkullimit financiar sipas pasqyrave financiare të dorëzuara në ATK.

**Arsyetim:** **A** - AK në asnjë rast nuk ka shfrytëzuar bashkëpunimin me OE, si dhe nuk ka drejtuar kërkesë për të dhënë sqarimet e nevojshme apo për të plotësuar dokumente të nevojshme, me qëllim që vendimi për dhënie të kontratë të mos jetë i qëllimshëm apo të duket si i parapërgatitur.

**B - Dosja e Tenderit** - Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT) Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, **Kërkesa 1 Arsyetim:** AK në specifikimet teknike të DT , neni 9.1 & 9.2, nuk ka kërkuar kontrata referenca specifike, por vetëm referenca të shërbimeve të ngjashme. OE: Ne si OE i kemi ofruar dy kontrata me referenca për shërbime të ngjashme. Pra, duke pasur parasysh që titulli dhe aktiviteti i projektit ka të bëjë me Mbledhjen e të dhënave statistikore, ndërsa, në anën tjetër, ne kemi ofruar dy referenca me tituj të projekteve: **1).** Hartimi i dokumentit të fizibilitetit për analiza hapësinore ekonomike dhe **2).** Referenca e dytë me titull "Modeli digjital i terrenit për komunën e Vitisë dhe Gjilanit". Këto referenca siç shihet tregojnë mjaft qartë se kemi të bëjmë me mbledhje të dhënave statistikore dhe gjeo-hapësinore për të cilat përdoret procedura e njëjte me titullin e projektit në fjalë.

Pra, qëllimi i të gjitha këtyre projekteve si në DT po ashtu edhe në referencat e ofruara nga ne, aktiviteti kryesor është Mbledhja e të dhënave;.

Si konkludim, referencat e ofruara nga ana jonë janë të njëjta me fushën dhe përshkrimin e këtij aktiviteti të prokurimit.

**Arsyetim 2:** AK në specifikimet teknike të DT), Kërkesa 2, ka kërkuar staf profesional të fushës së ekonomisë apo bujqësisë me kualifikim (Ekonomist i diplomuar apo Master). Pra nuk ka specifikuar kualifikimin si p.sh. Sistem katervjeçarë apo sistem Bachelor sipas istemit të Bolonjes. Keto të dy kualifikime janë ekuivalente diplomen në fakultetin ekonomik, vetëm se dallon numri i ETC kredive. Edhe sistemi e kaluar për universitetin ka pasur nivelet e shkollimit si: Katervjeçar - atehere / Bachelor - sot, ose Magjistatur - atehere / Master - sot.

Ne si OE i kemi ofruar staf të mjaftueshëm për realizimin e këtij projekti, me theks të veçantë: Ekonomist të diplomuar (Luljeta Krasniqi - Çela 15 vite provoj pune në statistika), Dr. Sc. (Enver Krasniqi, 10 vite provoj pune), Bachelor i ekonomisë Granit Kutllavci (5 vjet përvojë pune), Bachelor i ekonomisë Arlinda Daka (2 vjet përvojë pune, me theks të veçantë në anketa). Pra, në DT janë kërkuar 1 ekonomist i diplomuar ose master (pa u specifikuar sistemi katervjeçar apo sipas Bolonjes) dhe 2 bachelor ose master. Ndërsa, ne kemi ofruar katër (4) ekspert të fushës së Ekonomisë, prej tyre 1 Ekonomist i diplomuar (Master), 1 Dr.Sc. dhe dy bachelor. Për më tepër grada shkencore Bachelor, si procedura e diplomimit është ekuivalente me diplomimin e studenteve në sistemin e kaluar të arsimit. Pra, kjo si procedura nuk është e matshme prandaj edhe nuk mund të përdoret si kërkesë për të eliminuar apo kufizuar konkurrencën profesionale në projekte të natyrës së shërbimeve.

Si konkluzion ne kemi ofruar staf të mjaftueshëm për të plotësuar kriteret minimale të kërkuara në DT, dhe këto do të mund të sqaroheshin konform UDHËZUES Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, gjegjësisht nenit

10.1 Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve. Duke pasur parasysh sqarimet e lartshënuara, kërkojmë që OSHP ta marrë për bazë kërkesën tonë për rivlerësim, dhe tenderin ta kthejë në procedurë të rivlerësimit.

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**AK ka shkaktuar dëme materiale si: Qarkullim financiar për OE në vlerë prej 24868.50 euro**

**AK ka dëmtuar OE në vlerë financiare prej 5000 euro shpenzime operative**

**AK ka dëmtuar buxhetin e Qeverisë së Kosovës në vlerë prej: 2000.01 euro , duke përzgjedhur OE më të shtrenjët**

## **10. Lista e dokumenteve (dëshmi) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*